



REPUBLIKA EKOSOVËS
REPUBLIKAKOSOVA/REPUBLICOFKOSOVO

KËSHILLIPROKURORIALIKOSOVËS
TUŽILAČKISAVET
KOSOVA/KOSOVOPROSECUTORIALCOUNCIL

RAPORT TREMUJOR
(janar- mars 2015)

PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT
KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK

Prishtinë, Prill, 2015

HYRJE

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijësimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij Memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit të dizajnuara për të arritur dhe mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj infomate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë jo-formale; dhe
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit ose efektivitetit të programit;
9. Koordinatori Kombëtar do të misionojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe përcjell procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.
12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për Përzgjedhjen e e Shënjestrave të krimeve të Rënda dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional”;
13. Koordinatori Kombëtar poashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018”.

Prokurori i Prokurorisë Themelore, Departamenti i Krimeve të Rënda në Gjilan, Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij

dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

ANALIZA

Viti 2015 ka vazhduar me disa raste të suksesshme dhe për këtë flet fakti se kemi sekuestrime në vlerë ende të papërcaktuar por që pritjet janë se kemi të bëjmë me disa milionë euro kurse poashtu kemi edhe konfiskime përfundimtare në vlerë prej mbi 70.000 €, nëdisa raste (njërast ky nga PTH-ja në Ferizaj dhe prokurori Veton Shabani, prokuror në Departamentin e Krimeve të Përgjithshme).

Sidoqoftë rasti i sekuestrimeve të dhjetëra objekteve praktikisht ka filluar në fund të v. 2014 mirëpo që kërkesa është aprovuar vetëm në fillim të v. 2015, edhe atë nga sekuestrimi, GjPP-ja ka vendosur që objektet në fjalë ti lë nën masën e ngrirjes. Nga sekuestrimet e v. 2014 dhe ato të v. 2015 shihet se bëhet fjalë për sekuestrime të një niveli dukshëm të rritura në krahasim me vitet paraprake mirëpo që tani fokusi duhet të jetë i përqendruar në tri drejtime. E para ka të bëjë me atë se tani rastet e sekuestrimeve aktuale duhet të përpiqemi ti dërgojmë deri në fazën përfundimtare të tyre e që ky është konfiskimi. Drejtimi i dytë është që poashtu të kemi sekuestrime të reja me raste të reja ngase kemi të bëjmë me një fushë që vazhdimisht duhet të gjenerojë raste të reja dhe në fund drejtimi i tretë është se institucionet zbatuese të ligjit duhet të vënë në fokus edhe hetimin, gjykimin dhe konfiskimin epasurive të paligjshme në rastet e niveleve më të larta sepse vetëm kështu mund të themi se Kosova ka plotësuar plotësisht objektivat e saj dhe poashtu paralelisht me këtë do të ishim dëshmitar të kthimit të besimit në organet e ndjekjes dhe gjyqësorit në tërësi.

Kështu KK ka identifikuar disa fusha në të cilat mund të punohet dhe prodhohen rezultate konkrete dhe të gjitha këto i kemi evidentuar dhe theksuar vazhdimisht në secilin raport. Një nga fushat ku ka mundur të arrihet shumë më tepër dhe ku lirisht mund të themi se përpjekjet kanë dështuar është shitja e veturave të sekuestruara. Megjithëse kemi pasur disa vizita në PTH-të në Prishtinë, Gjilan e Ferizaj si dhe më pak në Gjakovë e Prizren, procesi nuk ka ecur përpara. Është një hezitim i pakuptueshëm nga ana e prokurorive që ky proces të vihet në binarë dhe tashmë KK ka shtjerrur të gjitha mundësitë të bëjë diçka tjetër më shumë dhe tashmë mbetet në KPK-në që të gjej mekanizmat për të detyruar prokuroritë për të vepruar sipas këtyre kërkesave. Arsyet për të vepruar janë të shumëfishta si ato se buxheti i vendit do të mbushej për qindra mijëra euro, se vlera e veturave nuk do të amortizohej, se edhe nëse gjykata do të vendos që pasuria ti kthehet të pandehurit, me shitjen e veturave të pandehurit do ti kthehet vlera adekuate në të holla dhe do të reduktohej mundësia e dëmshpërblimit për shkak të humbjes së vlerës së veturës, se shumë pjesë të veturave me qëndrimin në depo do të shkatërroheshin, se ato vetura funksionale do të mund tu barteshin agjencioneve të ndryshme si PK-së, PSH-së, KGJK-së, IPK-së, spitaleve etj. dhe kështu do të balancohej fakti se qeveria e R. së Kosovës ka vendosur të kursej në blerjen e veturave të reja, dhe nga fakti i thjeshtë se n. v. 2013 këto vetura do të shiteshin më shtrenjtë, në v. 2014 më pak, në v. 2015 akoma më pak kurse në v. 2016 apo 2017 mbase do të mund ti shesim vetëm për hekur, dhe pyetja që shtrohet është: çka duhet të bëhet më shumë për të kuptuar se këto janë veprime të dëmshme dhe në fund të fundit kush duhet të mbajë përgjegjësinë për një gjë të tillë kur buxheti i vendit po dëmtohet me mijëra e ndoshta edhe qindra mijëra euro????!!

Një gjë tjetër që tashmë është raportuar në tremujorin e tretë (korrik – shtator 2014, pika 12) dhe që paraqet parakusht për punë më cilësore dhe në hetimin e rasteve më të mëdha që ka vendi, është ndryshimi i ligjit për PSRK-në. Duke mos dashur të përsëritemi, e ri theksojmë se ligji i tanishëm është pengesë që kjo prokurori të ketë sukseset që realisht do të duhej ti kishte dhe është nevojë urgjente ndryshimi i këtij ligji.

Një gjë tjetër ku mund të punohet në shtigje afatshkurtëra por që mund të prodhojnë rezultate konkrete janë planet e KK-sëe të cilat do të prezantohen para Bordit Këshilldhënës në ditët në vijim në takimin që pritet se do të thirret nga Ministri i Drejtësisë.

Poashtu një vrojtim i KK-së është se ka nevojë që institucionet të jenë shumë më aktive në luftimin e krimin dhe kjo më së shumti u drejtohet udhëheqësve të institucioneve të ndryshme zbatuese të ligjit dhe kjo në rastet konkrete ku janë hasur vështirësitë. Pra, në mendimin tonë edhe sukseset e deritanishme më shumë janë suksese në bazë të një pune stihike apo të vet iniciativës dhe punës rutinësi dhe përkushtimit profesional të krijuar nga hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit sesa të një vizioni që kanë drejtues të institucioneve zbatuese të ligjit dhe kjo qasje nuk garanton një progres të cilin po e synojmë të gjithë.

AKTIVITETET NË PROCES E SIPËR

- Procesi i shitjes së veturave vazhdon të përballet me shumë vështirësi, sfida dhe hezitime nga ana e prokurorëve. Pavarësisht infrastrukturës së qartë ligjore dhe lejimit të ndërmarrjes së kërkesave për shitje progresi është shumë i ngadalshëm, kurse ne nuk kemi asnjë justifikim përse po ndodhë një gjë e tillë. Kështu, PTH-të në Ferizaj dhe Gjilan kanë bërë hapa në këtë drejtim dhe KK ka qenë disa herë në vizita në këto dy prokurori. Sidoqoftë, progresi edhe në këto dy prokurori është i kufizuar dhe ende nuk kemi informata të mjaftueshme se ku ka mbërritur procesi i shitjes së këtyre veturave.
- Poashtu edhe për PTH-në në Prishtinë me ndihmën e PK-së kemi siguruar listën e veturave, ku ka mbi 106 vetura që janë të sekuestruara. Një menaxhim adekuat i tyre dhe veprimi në pajtim me dispozitat ligjore do të kishte për efekt që një numër i veturave që janë të reja dhe në gjendje të rregulltë ti jepën institucioneve të ndryshme për shfrytëzim dhe duke pasur parasysh vendimin e Qeverisë së R. së Kosovës për reduktim të shpenzimeve në këtë drejtim, dhënia e këtyre veturave do të mbulonte hendekun eventual të krijuar për nevoja të institucioneve të ndryshme kurse një numër tjetër i veturave do të mund të shitej dhe sërish ato para të derdhen në buxhetin e vendit. Me dt. 06.01.2015, KK ka kërkuar zyrtarisht nga PTH-ja në Prishtinë të fillojë procesin e shitjes së këtyre veturave dhe deri në përmbyllje të këtij tremujori kemi marrë informatën se lëndët tashmë u janë ndarë prokurorëve të rasteve por që ende nuk kemi informata nëse është vepruar në pajtim me to apo jo. Kështu, tashmë KK ka arritur në limitin e mundësive të tija dhe nga tash e tutje është në përgjegjësinë e KPK-së të shikoj se cilat janë masat me të cilat mund të arrihet qëllimi i caktuar, se cili është qëndrimi dhe arsyetimi që prokurorët kanë hezitim të veprojnë në këto raste, sa janë arsyet e tilla të qëndrueshme, sa janë implikimet monetare apo dëmet që vazhdimisht po thellohen dhe përfundimisht si të zgjidhet një situatë e tillë.
- Me kërkesë të KK-së, U.D i Prokurorit të Shtetit ka lëshuar një vendim me të cilin një prokuror i PTH-së në Prishtinë është autorizuar të merret me raste me të cilat parashihet që një sektor i shoqërisë të vihet nën kontroll në drejtim të pagimit të taksave. Sidoqoftë, nga prokurori i rastit kemi mësuar se progresi ka qenë i

ngadalshëm ngase prokurorit në fjalë nuk i janë krijuar lehtësi nga shkarkimi me lëndët që ka në disponim dhe as lehtësi tjera. Sjellim në vëmendjen e KPK-së se ky proces dhe të tjera të ngjashme për të cilat kemi indikacione se bëhet fjalë për shmangie nga tatimet të subjekteve më të mëdha mund të sjellin efekte zinxhirore, qoftë në vënien nën kontroll të pagimit të tatimeve qoftë në inkasimin e shumave të konsiderueshme që mund të derdhen në buxhetin e vendit. Ky plan i hartuar nga KK dhe drejtori i NJIF-it kanë si qëllim që aspekte të ndryshme biznesore të vihen në kontrollin e pagimit të duhur të tatimeve dhe parashihet se nëse gjithçka shkon sipas planit, të hyrat në buxhetin e vendit mund të rriten për disa miliona euro, me efekt të përhershëm sepse të njëjtat sasi të hollave që do të arkëtohen do të duhej të arkëtoheshin edhe në vitet tjera.

Në vijim gjendet lista e elementeve më të rëndësishme për efektivitet të përmirësuar tek të gjitha institucionet të cilave u drejtohen:

Rekomandimet e tjera të precizuara gjatë v. 2014 vazhdojnë të mbesin aktuale dhe disa nga to mund të fillojnë të implementohet nga të gjitha institucionet të cilave u referohen.

1. REKOMANDIM PËR KPK-në dhe KGJK-në: Me qëllim që të kemi statistika sa më të sakta dhe që do të pasqyrojnë drejt rezultatet në fushën e sekuestrimeve dhe konfiskimeve, i propozojmë KPK-së dhe KGJK-së që në secilin rast ku ka pasur aktakuza me propozim për konfiskim apo aktgjykime në lidhje me këto raste, të kërkojnë nga prokurorët dhe gjykatësit e rasteve që të njëjtat të dërgohen edhe në zyrën tonë sepse kështu ne pos qëdo të kishim të dhëna të sakta për të freskuar shënimet statistikore poashtu këto materiale do të ndihmonin në analizën e tyre dhe publikimin e tyre në web faqen tonë nga ku do të përfitonin të gjithë, si prokurorët, gjykatësit, zbatuesit tjerë të ligjit dhe do të rritej transparencja ngase secili qytetar do të kishte qasje në leximin e rasteve të tilla duke kuptuar saktë se çka ka ndodhur dhe si është vendosur në raste konkrete. Në fund këto materiale do të mund të shfrytëzoheshin nga vet KPK dhe KGJK që si materiale të një lëmie të caktuar të prezentohen edhe në takime të rëndësishme me mekanizma ndërkombëtar ku do të mund të dokumentohej puna e sistemit gjyqësor në rastet ku ka konfiskim të pasurisë së paligjshme.

2. REKOMANDIM PËR KPK: Moszbatimi i duhur i LKZK-së, qoftë nga prokurorët vendor qoftë nga ata të EULEX-it. Zyrja e KK-së nuk ka shumë informacione se ka raste të hapura nga ky ligj që dëshmon se ka mungesë të njohjes së mirë të këtij ligji shumë të fuqishëm. Shfrytëzimi më i madh dhe më i mirë i këtij ligji do të kishte për pasojë një efikasitet më të lartë në ndjekjen e veprave penale që kanë gjeneruar përfitim pasuror dhe me këtë edhe rritje të aseteve të sekuestruara e më pas edhe të konfiskuara të përfitimit pasuror përmes veprave penale. Mbetet në KPK-në që të gjej mënyrat e duhura për të inkurajuar prokurorët në zbatimin e këtij ligji. Në të kundërtën Kosova dhe sistemi i drejtësisë rrezikon që të ndjekë efektivisht pasurinë e krijuar në mënyrë të kundërligjshme dhe në fakt të vihet pas dobisë pasurore të njohur si “mjetet me të cilat janë kryer veprat penale” dhe dobia pasurore e drejtëpërdrejtë që është përfituar me atë vepër penale por jo edhe në gjurmimin dhe konfiskimin e pasurisë së krijuar me “sjellje të ngjashme” kriminale të paraparë me dispozitat e LKZK-së. Dallimi mes aplikimit të dispozitave të regullta të konfiskimit përmes KPRK-së dhe KPP-së është deri diku i pranueshëm por një gjë e tillë nuk mund të thuhet edhe për dispozitat e LKZK-së, ngase shihet se këto dispozita janë aplikuar fare pak edhe pse ka pasur vend në disa raste që të aplikohen. Luftimi i suksesshëm i krimit ekonomik dhe krimeve tjera

që gjenerojnë përfitime pasurore mund të kryhet me sukses vetëm nëse prokurorët zbatojnë edhe dispozitat e LKZK-së.

3. REKOMANDIM PËR KPK DHE KGJK: Hezitimi i pakuptueshëm i prokurorëve për të shitur veturat dhe sendet që mund të pësojnë rënie të vlerës vazhdon të jetë shqetësues ngase shume pak është bërë konkretisht në këtë pikë. Kështu edhe Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 2014/42/EU, inkurajon vendet anëtare të BE-së që të bëjnë shitjen e tyre për të minimizuar humbjet.¹

4. REKOMANDIMI PËR KPK-në: Sikurse shihet nga raporti i fundit i KK-së për vitin 2014, ka pasur në total 253 kërkesa për konfiskim të përkohshëm, 16 urdhëra për ngrirje dhe 20 kërkesa për masa të përkohshme. Përpos faktit se kërkesat nuk janë proceduar sipas një kronologjie të përcaktuar me dispozitat e KPP-së e për të cilat kemi theksuar se ka nevojë për trajnime në këtë drejtim, edhe më indikativ është fakti se nga 253 kërkesat për konfiskim të përkohshëm sipas nenit 267 të KPP-së, kemi pasur 159 kërkesa të aprovuara. Sidoqoftë, edhe pse kjo statistikë në dukje të parështetë mjaft impesive, në anën tjetër, zyra e KK-së ka pranuar vetëm diçka mbi 30 kërkesa të tilla kurse për fatin e të tjerave ne nuk kemi njohuri. Andaj në mënyrë që vet sistemi prokurorial por edhe ai gjyqësor në tërësi, si dhe edhe vet shteti i Kosovës që të përfaqësohet sa më mirë tek mekanizmat ndërkombëtar, është e nevojshme që KPK të gjej mekanizma që të obligojë prokurorët dhe zyrtarët ligjor nëpër prokurori që të evidentojnë në mënyrë të saktë këto shënime në databazë kurse neve të na sigurojnë nga një kopje të tyre sepse vetëm kështu kemi mundësinë që të paraqesim statistika të plota dhe gjithëpërfshirëse dhe më pas në bazë të tyre të bëjmë analiza komparative kurse efekti do të ishte edhe në atë se Kosova do të paraqitej shumë më mirë me statistika të plota. Në bashkëpunim me Ekipin e Projektit të BE-së si dhe me zyrën ligjore në kuadër të KPK-së ne do të identifikojmë se cila prokurori sa raste ka dhe më pas ato do ti grumbullojmë nga secila prokurori kurse mbetet në KPK-në që të gjej mënyrën se si ti inkurajoj apo si të gjej mënyrat që prokurorët në të ardhmen ta kryejnë me përpikëri këtë detyrë.

AKTIVITETET E KOORDINATORIT KOMBËTAR:

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe raportuese:

- Nga dt. 26-30.01.2015, në Bruksel, KK ka marrë pjesë në Procesin e Dialogut mbi Stabilizimin dhe Asociacionin me përfaqësues të Komisionit Evropian të BE-së. Në këtë dialog janë diskutuar çështje të ndryshme e në veçanti të arriturat në fushën e sekuestrimeve dhe konfiskimeve dhe ku anëtarët e Komisionit Evropian janë shprehur të kënaqur me rezultatet e raportuara në këtë drejtim dhe rekomandimi vetëm i tyre ka qenë të vazhdohet me trajnime në dispozitat që mbulojnë këto çështje, propozim ky i cili edhe ashtu është paraparë nga KPK-ja.
- Me dt. 02.02.2015, KK ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga Lëvizja “Fol” ku është diskutuar puna e zyrës së Koordinatorit Kombëtar për periudhën një vjeçare.
- Me dt. 06.02.2015, KK është takuar me ekspertët në kuadër të PSRK-së dhe ku janë diskutuar aspekte të ndryshme në interesin e përbashkët.
- Me dt. 09.02.2015, 23.02.2015, 12.03.2015, KK ka vizituar PTH-në në Ferizaj ku janë diskutuar çështje të ndryshme.

¹Directive 2014/42/EU of the European Parliament and of the Council, page 4, paragraph 32

- Me dt. 10.02.2015, KK ka takuar ekspertët financiar të certifikuar së fundmi nga PK-ja, Dogana e Kosovës dhe ATK-ja.
- Me dt. 20.02.2015 dhe 30.03.2015, KK është takuar me ekspertin gjerman të hartuesit të KPK-së, z. Stefan Trunk.
- Me dt. 18, 19 dhe 20.02.2015, KK ka marrë pjesë në cilësi të ligjëruesit për zyrtarët e AAPSK-së në lidhje me çështje të ndryshme të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive.
- Me dt. 24.02.2015, KK është takuar me një delegacion të KE-së.
- Me dt. 25.02.2015, KK është takuar me zyrtar të Këshillit Drejtues të Projektit.
- Me dt. 25.02.2015, KK ka marrë pjesë në Mbledhjen e 7 të Këshillit Drejtues të Projektit ku janë diskutuar çështje të ndryshme rreth AAPSK-së, është aprovuar raporti tremujor dhe janë diskutuar aspekte të ndryshme të luftës kundër kimit ekonomik dhe mundësive për bashkëpunim më të intensifikuar mes faktorëve relevant.
- Me dt. 03.03.2015, KK së bashku me ekspertët ndërkombëtar, z. Cedric Woodhall dhe Alan Bacarese (drejtues të projektit) ka marrë pjesë në një takim me prokurorët e PTH-së në Prishtinë ku janë diskutuar raste të ndryshme në punë që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme.
- Me dt. 04.03.2015 KK së bashku me një ekspert anglez (prokuror) ka vizituar PTH të Gjakovës.
- Me dt. 04.03.2015 KK së bashku me një ekspert anglez (prokuror) ka vizituar PTH të Prizrenit.
- Me dt. 09.03.2015, KK është takuar me z. Jutta Henneberger, nga Ministria Federale e Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të Gjermanisë.
- Me dt. 13.03.2015, KK ka vizituar PTH-në në Gjilan.

SFIDAT DHE DËSHTIMET

- Dështimi i arritjes së marrëveshjes së fajësisë në një rast të konfiskimit potencial. Në këtë rast kallëzimi penal ka ardhur nga Dogana e Kosovës ku është pretenduar një shmangie në vlerë prej miliona euro përderisa një ekspertizë dhe një vendim gjykatë në shkallë administrative ka bërë fjalë për shuma dukshëm nën vlerën e pretenduar nga dogana dhe ku bëhet fjalë për dhjetëra mijëra euro. Duke qenë se prokurori i rastit ka pasur në dijeni provat kontradiktore si dhe duke pasur parasysh interesin më të mirë të drejtësisë, duke ruajtur buxhetin e vendit, dëmin që i është shkaktuar Doganës së Kosovës, shanset për sukses të rastit dhe trajtimit të tij në dritë të drejtshëmërisë, proporcionalitetit dhe seriozitetit të veprës penale si dhe të gjitha rrethanat e tjera të rastit (rrethana këto që nuk mund të publikohen në raport) i ka ofruar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij një marrëveshje të fajësisë që ka implikuar detyrimin e të pandehurit në kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj Doganës së Kosovës dhe një konfiskimi të disa aseteve në pronësi të të pandehurit dhe kjo shumë e aseteve të konfiskuara do të arrinte shumë prej disa qindra mijëra eurove. Sidoqoftë, deri te arritja e marrëveshjes së fajësisë nuk është arritur për shkak të këmbënguljes së Doganës së Kosovës se i pandehuri është “detyruar të paguajë shumë të vogël dhe jo

proporcionale me dëmin e shkaktuar” andaj kanë këmbëngulur që më vonë të kenë të drejtë të padisin të pandehurin për pjesën tjetër të pretenduar. Kjo ka minuar dhe pamundësuar arritjen e marrëveshjes së fajësisë dhe për këtë përgjegjësia duhet të kërkohej direkt tek Dogana e Kosovës. Disa ditë më vonë, megjithatë është arritur kontakti me MF-në dhe ministri është treguar shumë bashkëpunues për situatën në fjalë por që duket se nga zyrtarët e tij nuk është informuar në mënyrë adekuate mbi rëndësinë që ka pasur takimi i kërkuar. Sfidë mbetet që koordinimi në të ardhmen të bëhet në mënyrë më efektive dhe të evitohen situata të tilla që mund ta dëmtojnë buxhetin e vendit por edhe procesin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve.

- PTH-ja në Gjilan qysh gjatë muajit nëntor të v. 2014 ka kërkuar nga GJTH në Gjilan që të aprovojë kërkesën që një veturë e konfiskuar të kalojë në shfrytëzin të qeverisë, respektivisht të PK-së, mirëpo që nga ajo kohë nuk ka informacione nëse është vepruar apo jo pavarësisht faktit se nëse vetura qëndron një dimër të tërë në depo, e njëjta do të mund të dëmtohet. Në këto raste, duhet të kihet parasysh që të veprohet më me urgjencë dhe që të mos shkaktohet dëm i panevojshëm.
- Në mungesë të përkthyesit, KK nuk ka mundur të zbatoj premtimin mbi përkthimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe ku shumë vendime mbi konfiskimet do të publikoheshin në web faqen e KK-së e nga ku do të mund të përfitonin, gjykatësit, prokurorët, avokatët dhe të gjithë të interesuarit tjerë.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- Gjatë periudhës janar – mars 2015, KK-ja në cilësi të përfaqësuesit të Kosovës në rrjetin joformal CARIN, që është një rrjet joformal i kontakteve dhe grup bashkëpunues në të gjitha aspektet e ndalimit të përfitimit nga krimi, pjesë e së cilës është edhe Kosova, në cilësi të vëzhguesit, ka dërguar 0 kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare. Sidoqoftë për rastet e dërguara në v. 2014 kemi pranuar përgjigje në këtë tremujor, edhe në atë 3 raste, 2 përgjigje kanë ardhur nga Kroacia kurse 1 përgjigje tjetër ka ardhur nga Sllovenia.

SEKTORI I PARANDALIMIT DHE DETEKTIMIT

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Legjislacioni:

BQK si pjesë e grupit punues për plotësim-ndryshimine ligjit PP/FT, ka marrë pjesë në takimet e rregullta me ekspertët e Këshillit të Evropës dhe grupin punues ku i kemi dhënë kontributin dhe komentet tona.

Operacionet:

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer aktivitete në terren. Janë kryer inspektime/ekzaminime në fushën PP/FT në institucionet financiare si në vijim:

1. Raiffeisen Bank
2. Capital

3. Kreditimi Rural i Kosovës
4. KEP Trust.

Bashkëpunimi

Takime me delegacionin e FMN-së në kuadër vlerësimit të sistemit të PPP/FT si dhe takimi përmbyllës në kuadër të projektit për mbështetjen e institucioneve të Kosovës në luftimin e krimit ekonomik dhe financiar.

NJIF-K

Me 05 Shkurt 2015, Qeveria e R. së Kosovës ka miratuar Koncept Dokumentin për ndryshim plotësimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ndërsa me datë 13.02.2015, me vendim të Ministrisë së Financave Nr.32/2015, themelohet grupi punues për draftimin e ligjit. Deri në fund të Marsit 2014, grupi punues ka mbajtur 4 takime për ndryshimin e ligjit, ku në mesin e tyre është mbajtur takimi edhe me dy ekspertët ndërkombëtar të angazhuar nga projekti PECK i financuar nga BE dhe KiE.

Në muajin Janar janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy Urdhëresa Administrative:

- Urdhëresa administrative NJIF-K nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe
- Urdhëresa administrative NJIF-K nr. 03/2015 për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit.

Përderisa më 13.01.2015, Drejtori i NJIF-K ka miratuar dokumentin strategjik të NJIF-K "Plani i Performancës dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017", i cili pritet të implementohet në tri vitet e ardhshme.

Ne muajin Janar 2015, Drejtori i NJIF-K ka miratuar 4 SOP:

- 1) Procedura Standarde e Operimit mbi Procesin e Punës së NJIF-it për Analiza dhe Inteligjencë (13.01.2015)
- 2) Procedura Standarde e Operimit për Goaml bazuar në Proceset e Punës (13.01.2015)
- 3) Procedura Standarde e Operimit për Statistikat e NJIF-K (13.01.2015)
- 4) Manual i Përdoruesit për formularët goAML (13.01.2015).

Në periudhën Janar - Mars 2015, NJIF-K ka pranuar:

- 87 Raporte të transaksioneve të dyshimta (RTD-STR), përderisa ka pranuar edhe 1 (një) raport të dyshimtë për financim të terrorizmit (TFR). Krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi dyfishim të raportimit të këtyre transaksioneve të dyshimta.
- Në këtë periudhë raportuese janë mbyllur 39 raste, ndërsa prej tyre 33 raporte janë shpërndarë tek autoritetet tjera të zbatimit të ligjit, përderisa gjashtë (6) raste janë mbyllur si jo të dyshimta.

Në periudhën raportuese Janar-Mars 2015, NJIF-K ka ndërmarr 22 Inspektime të pajtueshmërisë, prej të cilave 2 inspektime janë kryer Ad-Hoc, 2 inspektime me fushëveprim të kufizuar, 9 inspektime me fushëveprim të plotë, dhe 9 inspektime pasuese.

Në fund të muajit Janar është mbajtur takimi i Grupit Egmont në Berlin, Gjermani. Njëra nga pikat e diskutimit në takimin e grupit Ligjor ka qenë edhe plotësimi i kushteve për anëtarësim nga ana e NJIF-K. Rekomandim i vetëm ka qenë që Kosova duhet t'i bëjë ndryshimet ligjore sa i përket financimit të terrorizmit, me qëllim që pjesa ligjore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Kosova të vazhdoj rrugën e anëtarësimit në Egmont.

NJIF-K ka nënshkruar dy Memorandumeve të Mirëkuptimit me FIU Hungari dhe FIU Gana, përderisa është ri-nënshkruar marrëveshja e re e bashkëpunimit me FIU Maqedonia.

Në periudhën e parë të vitit 2015 NJIF-K ka krijuar qasjen direkte në Databazën e Regjistrimit Civil dhe Regjistrimit të Automjeteve. Kjo është arritur përmes nënshkrimit të MM në mes ARC dhe NJIF-K (aktiviteti 3.5).

Në tremujorin e parë të vitit 2015, NJIF-K dhe ILECUs janë pajtuar për ricaktimin e pikave të kontaktit, ku NJIF-K ka caktuar zyrtarin ndërlidhës me ILECUs.

- Pjesëmarrja e NJIF-K në Grupin Punues të Këshillit Prokurorial të Kosovës për bashkëpunim ndër institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit
- Pjesëmarrja e NJIF-K në Grupin Punues të Këshillit Prokurorial të Kosovës për Harmonizimin e raporteve statistikore
- Pjesëmarrja e NJIF-K në Sekretariatën e Grupit të Përhershëm Qeveritar për Parandalimin e Ekonomisë jo-formale 2014-2018.
- NJIF është pjesë e disa strategjive vendore, 1) Strategjia kundër krimit të organizuar, 2) Strategjia për parandalimin e krimit, 3) strategjia kundër terrorizmit dhe 4) strategjia për liberalizimin e vizave dhe MSA-ja. NJIF raporton në mënyrë periodike, sipas kërkesës në lidhje me zbatimin e aktiviteteve që rrjedhin nga planet e veprimit të këtyre strategjive

Deri më tani nuk është bërë ndërrimi i Objektivit dhe zyrave të NJIF-K.

SEKTORI I TRAJNIMIT

Aktivitetet për këtë periudhë raportuese:

Policia e Kosovës ka raportuar për këto aktivitete në fushën e trajnimeve:

1. Trajnim për hetimin e Korrupsionit, 12 zyrtar,
2. Trajnimi i Përgjithshëm për Hetimin e Krimit të Organizuar-15 zyrtar.

SEKTORI I LUFTIMIT TË KRIMIT EKONOMIK

Aktivitetet për këtë periudhë raportuese:

- Lista me qasje të kufizuar të krimeve me potencialin më të lartë për konfiskime të dobisë pasurore të përfituar përmes krimit vazhdimishtëzazhurnuar dhe tashmë në këtë listë kemi të evidentuara mbi 55 raste.
- Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe tremujore, janar – mars 2015, nga top lista prej 50 rasteve, simasa të ngrirjes apo sekuestrimit kemi këto mjete:

| Masa e Ndërmarrë | Para | Objekte | Vetura | Lokale | Tokë | Të tjera. |
|-----------------------|---|---|---|--------|----------------------|---|
| Të ngrira | 23.250 €; 500CHF: 300 \$ | 13 biznese- objekte- pompa të benzinës. Vila SËISS (14.500 m2) | 5 vetura (1 pasat, 2golfa, 1 sharan, 1range rover, 1 kamion benz) | | 14.500 metra2 | 74 rezervuare të naftës, 10 autobote dhe të tjera |
| Tësekuestuara | 200.000 € 39.000 € 2.420 € | Banesë 76.3m2- Prishtinë | 1 veturë, (Mercedes) 1 veturë(BMË) | | | Te rasti i 200.000 € tashmë kemi aktgjykimin e marrë në shkallë të parë |
| TOTALI | 265.470 € | 15 OBJEKTE | 7 VETURA | | 14.500 m2 | 84 asete tjera |
| Të konfiskuara | 35.789 euro + 6 aktgjykime tjera në vlerë prej 28,698 | | | | | (119 telefona, janë shitur në vlerën prej 35.789€) |
| TOTALI | 64.487 € | | | | | |
| Masa të tjera | | | | | | |

Për shkak të shumë specifikave dhe ndërlikueshmërisë së vlerësimit të këtyre aseteve, këtë periudhë kohore nuk jemi në gjendje të bëjmë një vlerësim të përafërt të vlerës së këtyre aseteve por meqenëse AAPSK-ja ka tashmë ekipin që po merret me këtë punë, presim që raportin tjetër të dalim edhe me vlerësim mbi atë se cila është vlera e përafërt e shprehur në të holla e aseteve të ngrira dhe të sekuestuara.

KONFISKIMET PËRFUNDIMTARE

Fatmirësisht edhe për periudhën e parë raportuese janar – mars 2015 kemi konfiskime përfundimtare dhe bëhet fjalë për një shumë prej 35,789.00 €, para të gatshme që tashmë janë derdhur në buxhetin e qeverisë së R. së Kosovës. Ky rast është hetuar dhe ndjekur nga PTH-ja në Ferizaj dhe prokurori i Departamentit të Përgjithshëm, z. VETON SHABANI.

PTH Ferizaj, PP. Nr. 466-4-14, 10.03.2014

Gjykata Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, P. Nr. 77/14.

Kurse 6 raste më të vogla kapin shumën prej 28,698.00 €.

TOTALI: 64,487.65 €.

SHËNIME STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të pranuar gjatë periudhës janar - mars 2015, flasin si në vijim:

- Është lëshuar vetëm 1 urdhër sipas nenit 264 të KPP-së, apo urdhrave për ngrirje të përkohshme të aseteve, edhe ky urdhër është lëshuar nga PSRK-ja;
- Është lëshuar vetëm 1 kërkesë për dhënien e përkohshme të urdhrit sipas nenit 265 të KPP-së, apo urdhrave ndalues, dhe kjo kërkesë është lëshuar nga PTH-ja në Prishtinë;
- Janë lëshuar 32 kërkesa për konfiskim të përkohshëm sipas nenit 267 të KPP-së, edhe atë 22 kërkesa të tilla nga PSRK-ja, 3 nga PTH-ja në Gjiilan, 1 nga PTH-ja në Prizren, 2 nga PTH-ja në Prishtinë, 4 nga PTH në Ferizaj, 0 nga PTH-të në Gjakovë e Mitrovicë. Prej 32 kërkesave të tilla, gjykatat kanë aprovuar deri më tani 17 kërkesa të tilla. Prokurorët e EULEX kanë raportuar 0 kërkesa të tilla.
- **VËREJTJE:** Databaza e evidenton se është lëshuar vetëm një urdhër sipas nenit 264 dhe sërish vetëm një urdhër tjetër sipas nenit 265 të KPP-së, por ajo që është indikative është fakti se këto kërkesa janë lëshuar në njërin rast nga PSRK-ja kurse në rastin tjetër nga PTH në Prishtinë. Sipas të gjitha gjasave bëhet fjalë për mos mbajtje të shënimeve në mënyrën e duhur sepse kur lëshohet urdhëri për ngrirje sipas nenit 264 atëherë ka shumë të ngjarë, edhe pse jo plotësisht e domosdoshme, që të lëshohet kërkesa tjetër sipas nenit 265 përderisa nëse është lëshuar kërkesa sipas nenit 265 atëherë asaj medoemos i ka paraprirë urdhëri sipas nenit 264 dhe kjo flet për atë se sa e paqëndrueshme është një databazë e tillë ngase shënimet nuk po futen në mënyrën e duhur.

Data baza vazhdon të evidentojë se nuk ka pasur as edhe një kërkesë që ka të bëjë me pasurinë e konfiskuar respektivisht kërkesat për kalimin e aseteve në shfrytëzim të qeverisë, kërkesa për kompensim të të dëmtuarit, kërkesa për shitje të sendeve të konfiskuara apo asgjësim të sendeve të konfiskuara dhe një gjë e tillëtashme duhet të kthehet në pikë diskutimi për anëtarët e KPK-së për të shikuar se përse rubrikat e tilla vazhdojnë të jenë me shifrat zero dhe ku qëndrojnë arsyet për një mosveprim të tillë.

Më tej në rubrikën e kërkesave të prokurorit për konfiskim të përhershëm të sendeve të fituara me vepra penale, të parashtruara sipas aktakuzës për të gjitha prokuroritë, rezulton se kemi të bëjmë me gjithsej 35 kërkesa të tilla. Prin PTH-ja në Ferizaj me 20 kërkesa të tilla, e pasuar nga PTH-ja në Gjiilan me 6 kërkesa të tilla, PTH në Prizren poashtu me 6 kërkesa të tilla, PTH në Pejë me 3 kërkesa kurse PTH-të në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë kanë raportuar zero kërkesa të tilla. Bëhet fjalë për shuma të vogla ngase nënjë rast në PTH të Gjiilanit është kërkuar konfiskimi i 900 € parave të gatshme dhe në një rast tjetër në PTH të Ferizajt janë kërkuar të konfiskohen 634 €. Marrë në tërësi, kjo rubrikë flet se për këtë periudhë kohore janë kërkuar të konfiskohen me aktakuzë 210.000 €, si para të gatshme, automjete, barna etj.

VËREJTJE: është vështirë e imagjinueshme të mendohet se PTH-ja në Prishtinë ka 0 kërkesa kurse PTH në Ferizaj ka 20 kërkesa të tilla dhe duket se problemi vazhdon të qëndrojë në mos evidentimin e shënimeve në databazë dhe kjo është një çështje urgjente e cila duhet të adresohet nga KPK për ta evituar në të ardhmen.

Kjo periudhë kohore rezulton me zero raste kur prokurorët kanë kërkuar masa të përkohshme të sigurisë së pasurisë, ruajtjen e sendeve apo kërkesa për shitje të sendeve të konfiskuara përkohësisht.

Sa i përket rubrikës që ka të bëj me sendet e konfiskuara nga gjykata me aktgjykim, databaza gjeneron të dhëna nga të cilat shihet se në këtë periudhë kohore kemi 9 aktgjykime përfundimtare në lidhje me konfiskimin e pasurisë, nga të cilat 4 kanë të bëjnë me konfiskime të automjeteve (PTH në Gjilan 2 dhe PTH në Ferizaj 2 automjete) dhe 5 raste tjera të konsifikimit të drogave të ndryshme.

Kurse në total, në kapitullin e veprave penale kundër EKONOMISË, për periudhëjanar – mars 2015, 14 persona për të cilët gjykata ka marrë vendime përkitazi me aktakuzat e ngritura, ku 13 raste janë në GJTH të Prizrenit dhe 1 në GJTH të Ferizajt ndërsa që gjykatat tjera nuk kanë evidentuar asnjë vendim gjyqësor të marrë. Në 1 rast, edhe atë në GJTH të Ferizajt aktakuza është hedhur para shqyrtimit gjyqësor, në 4 raste i akuzuari është shpallur fajtor dhe të 4 rastet i përkasin GJTH në Prizren, për 9 persona aktakuza është refuzuar ndërsa në 1 rast është paraqitur ankesë nga ana e prokurorit. Janë raportuar 0 raste kur ka pasur kërkesa të prokurorit për caktimin e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës së drejtpërdrejtë, kërkesat e aprovuara nga gjykata, ankesat e prokurorit në vendimet e gjykatës për caktimin e paraburgimit dhe ankesat e aprovuara nga Gjykata e Apelit.

PTH në Gjilan ka bërë 7 kërkesa për informata shtesë, PTH në Prizren 29 të tilla, PTH në Peja 13, PTH në Mitrovicë 3 kurse PTH në Ferizaj 2 të tilla. Sërish kemi PTH në Prishtinë, Gjakovë pa asnjë kërkesë të tillë të paraqitur. Në total janë 54 kërkesa për informata shtesë.

VËREJTJE: Shihet sa numri i këtyre kërksave ndryshon dhe NJSHVPP duhet të analizojë mbi shkaqet e këtyre ndryshimeve, respektivisht nëse disa prokurori janë më të kënaqura me kallëzimet penale të paraqitura nga ana e policisë dhe institucioneve tjera zbatuese të ligjit apo prokuroritë janë më kërkuese në hartimin e aktakuzave sa më të plota dhe cilësore.

Janë gjithsej 22 aktvendime mbi fillimin e hetimeve për kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë, dhe PSRK-ja ka 3 aktvendime të tilla, PTH në Gjilan 4, PTH në Prizren 8, PTH në Peja ka 1, PTH në Mitrovicë ka 3 dhe PTH në Ferizaj ka 3 aktvendime të tilla. Sërish PTH në Prishtinë rezulton me 0 aktvendime të tilla.

Janë 2 kërkesa për caktim të paraburgimit dhe të dy kërkesat janë lëshuar nga PTH-ja në Mitrovicë. Kurse rezulton se asnjëra nuk është aprovuar nga ana e gjykatës.

Janë raportuar 0 ankesa në vendimin e gjykatës për caktimin e paraburgimit.

Poashtu kemi 0 ankesa të aprovuara nga ana e Gjykatës së Apelit.

Janë 7 aktvendime për zgjerim të hetimeve dhe të 7 kërkesat vijnë nga PSRK-ja dhe madje nga një prokuror i vetëm.

Poashtu kemi 0 raste kur është pezulluar hetimi. **VËREJTJE:** Këtë fakt KPK-ja dhe NJSHPP-ja duhet ta ketë parasysh ngase nëse ka vend për pezullim të hetimit dhe kjo nuk bëhet, mund të rrezikohet i tërë hetimi me kalimin e afatit të paraparë ligjor.

Janëparaqitur 6 urdhëresa për masa të fshehta por për shkak të natyrës së këtyre urdhëresave, në këtë raport nuk mund të jepet regjioni nga janë paraqitur.

Si dhe janë 0 raste kur janë rifilluar hetimet pas pezullimit të tyre.

Ndërsa të dhënat nga AAPSK-ja për periudhën janar- mars2015 flasin se AAPSK ka pranuar:

- 15 aktvendime për sekuestrime, në vlerë prej 735,965.54 €,

- 7 aktgjykime për konfiskime të pasurive të ndryshme, në vlerë prej 64,487.65 €
- TOTALI: 800,453.19 €.

VËREJTJE: sikurse shihet të dhënat nga AAPSK dhe databaza e PSH-së ndryshojnë shumë dhe qëndron fakti se një numër i rasteve nuk evidentohet fare në databazë dhe për këtë tashmë disa herë kemi tërhequr vërejtjen se kjo kërkon adresim të menjëhershëm.

Vlen të theksohet se statistikat që prezenton AAPSK dhe KK-ja nuk duhet domosdoshmërisht të përputhen ngase AAPSK regjistron çdo rast me çfarëdo vlere të pasurisë përderisa KK-ja në listën e tij evidenton vetëm rastet kur bëhet fjalë për shuma të konsiderueshme të përfitimit pasuror të kundërligjshëm. Pavarësisht kësaj është evidente se ka mospërputhje të lartë mes të dhënave të pranon KK dhe AAPSK ngase një numër i prokurorëve dhe gjykatësve fatkeqësisht nuk e angazhon AAPSK-në në administrimin e pasurive të sekuestruara.

DINAMIKA E ZHVILLIMIT TË RASTEVE NË GJYKATA

Pavarësisht faktit se është bërë lëvizje në drejtimin e duhur dhe se ka një luftë më të theksuar kundër krimit ekonomik por edhe veprave tjera penale që gjenerojnë përfitim pasuror, megjithatë ka edhe ngecje dhe vendnumërim dhe kjo shihet nga tabela si më poshtë ku janë të evidencuara rastet në proces e sipër ku ka potencial për konfiskim dhe ku aktakuzat tashmë janë ngritur:

1. Rastii shmangies nga tatimi. PPS. Nr. 50/13. PKR. Nr. 1046/13. Data 07.11.2013 paraqet ditën kur është ngritur aktakuza. Me datë 18.12.2014 është marrë aktgjykimi në shkallë të parë. Nga ajo kohë kanë kaluar 3 muaj dhe nuk ka lëvizje tjera (prokuror dhe gjykatës ndërkombëtar). Me dt. 16.03.2015, Kryetari i Gjykatës së Apelit ka konfirmuar se lënda në këtë gjykatë nuk ka arritur deri me datën e përgjigjes dhe rrjedhimisht nuk ka vonesë të kësaj gjykate në trajtimin e kësaj lënde. Nga Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX kemi kërkuar përgjigje nëse vonesa prej më shumë se 3 muajve është e zakonshme dhe kur gjykata mendon ta ndërmarrë veprimin e radhës. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë përgjigje. Ky rast është gjykuar nga një panel i përzier prej gjykatësve vendor dhe ndërkombëtar.
2. Rasti i ashtuquajtur MEDICUS. PPS. Nr. 02/09. PKR. Nr. 1072/13/2008. Data 15.10.2010 paraqet datën kur është ngritur aktakuza. Aktgjykimi është marrë në shkallë të parë mirëpo nuk kemi arritur ta sigurojmë datën e kësaj ngase nuk ka pasur përgjigje nga organi i prokurorisë. (prokuror dhe gjykatës ndërkombëtar). Me dt. 23.03.2015 i kemi drejtuar prokurorit të rastit (ndërkombëtar) dhe Gjykatës së Apelit për të marrë më tepër informata për këtë rast. Nga prokurori i rastit kemi mësuar se i njëjti është në dijeni se objekti në fjalë është shitur dhe se prokuroria po merret me zbardhjen e rrethanave në të cilat ka ndodhur shitja e objektit në fjalë. Sidoqoftë, fjala është për një rast të vjetër dhe në kohën e marrjes së këtij aktgjykimi (që nga koha e gjykatësve të UNMIK-ut) nuk ka ekzistuar legjislacioni aktual andaj kjo duket se ka shkaktuar këto vështirësi. Pas kontaktve me kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të Eulex-it kemi kuptuar se tashmë është caktuar përbërja e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit dhe këtij rasti maratonik mund të presim se do ti vie fundi. Me datë 30.03.2015 kemi kërkuar nga Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it të kuptojmë se kur pritet përafërsisht të merret vendimi nga Gjykata e Apelit. Nga zyrtarët e lartcekur

kemi pranuar informatën se ky rast maratonik pritet të marrë epilogun e saj gjatë muajve shtator/tetor të v. 2015.

3. Rast i krimit të organizuar dhe vrasjes së rëndë. PPS. Nr. 42/13. PPKRK. Nr. 86/2013-2013. Data 04.07.2014 paraqet datën kur është ngritur aktakuza. Nuk është e qartë nëse prokurori i rastit ka paraqitur kërkesë për konfiskim apo jo. Nga data e paraqitjes së aktakuzës kanë kaluar më tepër se 9 muaj dhe nuk është caktuar asnjë seancë gjyqësore.
4. Rast i krimit të organizuar, keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe pastrimit të parave. PPS. Nr. 22/09, GJPP. Nr. 181/09. Me datë 20.12.2012 Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë aktgjykim në shkallë të parë. Që nga ajo kohë kanë kaluar shumë se 1 vit e 4 muaj dhe ende nuk ka vendim nga Gjykata e Apelit????!! Sipas Gjykatës së Apelit, kjo lëndë është pranuar në këtë gjykatë me dt. 19.02.2013 dhe për lëndën në fjalë do të vendoset nga gjykatës të EULEX-it. Sidoqoftë, edhe me këtë informatë shihet se ka kaluar më tepër se 1 vit e 1 muaj dhe gjykatësit e EULEX-it ende nuk kanë marrë ndonjë vendim për rastin pavarësisht se bëhet fjalë për konfiskim eventual të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe se në rastin konkret bëhet fjalë për një të pandehur që dikur edhe vet ka qenë gjykatës. Nga Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX kemi pranuar përgjigje se ky rast është caktuar dhe ricaktuar dy herë tek gjykatës të EULEX-it për shkak të përfundimit të mandatit të tyre kurse në fund të dhjetorit të v. 2014 është paraparë të mbahet seanca publike e caktimit të panelit të gjykatësve dhe fatkeqësisht kjo nuk është arritur për shkak se një gjykatës ende pret emërimin nga KGJK-ja.
5. Rast i keqpërdorimit të pozitës zyrtare etj. PPS. Nr. 39/11, PPS. Nr. 22/09. GJPP. Nr. 296/11. Me datë 07.02.2013 nga prokurori i rastit është bërë kërkesa për konfiskim të pasurisë. Nuk kemi informata se kur është ndërmarrë veprimi i fundit nga ana e gjykatës.
6. Rast i krimit të organizuar, trafikimit me narkotikë, pastrim të parave. PPS. Nr. 48/2013. PNKR. Nr. 70/2013. Data dhjetor 2013 është dita kur është paraqitur aktakuza. Nuk ka të dhëna se çka ka ndodhur më tej dhe kur është ndërmarrë veprimi i fundit nga ana e gjykatës.
7. Rasti i trafikimit me qenie njerëzore, pastrim të parave dhe shmangies nga tatimi. PPS. Nr. 08/2014. PKR. Nr. 103/14. Data 20.06.2014 paraqet ditën kur është paraqitur aktakuza. Që nga ajo kohë kanë kaluar më tepër se 9 muaj dhe nuk ka asnjë veprim tjetër.
8. Rast i keqpërdorimit të pozitës zyrtare. PPP. Nr. 28/2013. me dt. 27.11.2014 Gjykata Themelore në Prizren ka aprovuar kërkesën për sekuestrim. Nuk ka të dhëna tjera se cili dhe kur është veprimi i fundit i gjykatës.
9. Rast i shmangies nga tatimi. PPS. Nr. 90/2012. PPKRK. Nr. 122/13. Me dt. 25.02.2014 është ngritur aktakuza. Nuk ka të dhëna tjera se cili dhe kur është veprimi i fundit i gjykatës.
10. Rast i shmangies nga tatimi. PPS. Nr. 45/12, PKR. Nr. 282/2014. Me datë 04.02.2015 është shpallur aktgjykim në shkallë të parë ku janë të sekuestruara 200.000 €. Nga

Gjykata e Apelit kemi marrë informatën se lënda në këtë gjykatë ka arritur me dt. 25.03.2015 kurse lënda ka marrë shifrat PAKR. Nr. 52/14 dhe është në kompetencë të gjykatësve të EULEX-it.

11. PPS. 52/10. PKR. Nr. 362/12. Me dt. 29.11.2011 është ngritur aktakuza. Me dt. 13.03.2015 është mbajtur seanca e fundit në shkallë të parë. Rasti procedohet në Gjykatën Themelore të Pejës.
12. PPS. Nr. 08/2011. GJJP në Mitrovicë 06/2011. Rast ku hetimet janë pezulluar.
13. Rast i marrjes së ryshfetit, ushtrimi i ndikimit, dhënie e ryshfetit. PP. Nr. 261/13, rast në PTH, DKR-ja në Prishtinë. Në gjykatë ka shifrat PP. Xx. Veprimi i fundit nga ana e Gjykatës Themelore të Prishtinës është ndërmarrë me dt. Xx.xx.xxxx.
14. Rasti i marrjes së ryshfetit. PP.I. nr. 302/2013. PKR. Nr. 663/13. Aktakuza është ngritur me dt. 25.11.2013 në GJTH të Gjilanit. Rast ku ka mundësi të aplikohet neni 6 i LKZK-së. Veprimi i fundit nga ana e gjykatës është ndërmarrë me dt. 13.03.2014. Që nga ajo kohë ka kaluar 1 vit dhe më nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër???!!!
15. Rasti në prokurori ka shifrat, PP. Nr. 261/13 kurse në Gjykatën Themelore të Prishtinës ka shifrat PKR. Nr. 1002/13. Seanca e fundit është mbajtur me dt. 29.04.2014. Të sekuestruara janë para në shumë prej 4.500 €.

Procedurat Standarde të Veprimit mbi Shënjestrimin e Krimeve më të Rënda dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional

- Raste të përzgjedhura deri me tani janë 7 sosh.
- Nga te gjitha rastet e përzgjedhura në kuadër të PSV, deri tani kemi dy (2) aktakuza të ngritura të cilat presin gjykimin për vepra të ndryshme penale. Dy nga këto raste kanë qenë në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Njëri nga rastet ka qenë në punë tek prokurori vendor ndërsa rasti tjetri tek prokurori i EULEX-it.
- Rasti tek prokurori ndërkombëtar i EULEX-it ka të bëjë me një kompani publike. Janë 7 të pandehur të përfshirë në aktakuzë, ndërsa vlera e dëmit të shkaktuar është 6.182.609,76 Euro.
- Rasti tek prokurori vendor si të pandehur ka Organin Shqyrtues të Prokurimit, ekspertë të brendshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit si dhe biznesmen të kompanive. Numri i të pandehurve të përfshirë në aktakuzë është 4 persona, ndërsa dobia pasurore të cilën kompania fituese ka përfituar nga kjo kontrate dyshohet se është 1.779.759,54 Euro.
- Rastet tjera të shënjestruara janë në faza të ndryshme të hetimeve për të cilat janë ndërmarrë veprime të ndryshme hetimore. Për secilin rast deri më tani janë ndërmarrë dhjetëra veprime hetimore, madje ka rast në të cilën janë ndërmarrë më shumë se 100 veprime hetimore- përfshirë këtu edhe hetimet preliminare.

STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIN E PARAVE, FINANCIMIN E TERRORIZIMIT DHE KRIMEVE FINANCIARE 2014 – 2018

KK ka hartuar një plan të cilin më detajisht do ta prezantoj në takimin e Bordit Këshilldhënës që duhet të mbahet ditëve në vijim dhe duhet të thirret nga Ministri i Drejtësisë. Plani mëton që të hyrat në buxhetin e qeverisë së vendit të rriten duke luftuar ekonominë joformale dhe njëkohësisht duke trajtuar disa vepra penale më karakteristike për disa milionë euro dhe parakusht për këtë është mbështetja e institucioneve që kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për themelimin e zyrës së KK-së. Për shkak të specifikave, përmbajtjes dhe natyrës së planit e njëjta nuk mund të bëhet publike në tërësi për opinionin dhe rrjedhimisht as në këtë raport. Plani specifikon sektorët ku do të përfshihej prokuroria por edhe institucionet tjera zbatuese të ligjit, kohëzgjatjen e saj, rikthimin e tatimeve të humbura në buxhetin e vendit, rritjen e vetëdijësimit dhe përcjellja e implementimit të saj në vitet në vazhdim si dhe detyrimet e secilit institucion në Kosovë.